

NJOFTIM PËR KONTRATË

☒ **PUNË**☐ **FURNIZIM**☐ **SHËRBIME**

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: **15.06.2021**

Nr i Prokurimit	623-21-2485-5-1-1
Nr i brendshëm	623-21-023-5-1-1

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË		
Adresa Postare: XHELAL HAJDA TONI		
Qyteti: RAHOVEC	Kodi postar: 21000	Vendi: Kosovë
Personi kontaktues: Astrit Mullabazi		Telefoni: 038/200-45316
Email: prokurimi.rahovec@gmail.com prokurimi.rahovec@rks-gov.net		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet): https://kk.rks-gov.net/rahovec/		

Po



Jo



Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po



Jo



Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referojnë një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
RREGULLIMI I KANALEVE TË KULLIMIT TË TOKAVE BUJQËSORE

II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit
(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

☒ Punë	☐ Furnizime	☐ Shërbime
☒ Ekzekutim ☐ Plani dhe ekzekutimi ☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	☐ Blerja ☐ Qira financiare (lizing) ☐ Qira ☐ Blerje me këste ☐ Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
NË KOMUNËN E RAHOVECIT

II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë
☐

II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë (nëse aplikohet):

Kontrate publike kornizë me një operator
☐

Kontrate publike kornizë me disa operator
☐

Ekzekutimi i kontratës:

Thirrje/Porosi
☐

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë
☐

Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës
RREGULLIMI I KANALEVE TË KULLIMIT TË TOKAVE BUJQËSORE

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):

45246100-4

II.1.7) Variantet pranohen

Po ☐ Jo ☒

II.1.8) Ndarja në Pjesë

Po ☒ Jo ☐

Nëse *po*, tenderët mund të dorëzohen për (shënoni vetëm një kuti)

☐ vetëm një pjesë ☒ Të gjitha pjesët

II.1.9) Informacione lidhur me pjesët (nëse aplikohen)

Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër
Grupi 1.	Lot 1 – NDËRTIMI I KANALIT TË TOKAVE NGA SHTAVICA DERI NE FORTESE	Lot 1 – NDËRTIMI I KANALIT TË TOKAVE NGA SHTAVICA DERI NE FORTESE
Grupi 2.	Lot 2 – NDËRTIMI I KANALIT TE KULLIMIT FORTESE – CELINË	Lot 2 – NDËRTIMI I KANALIT TE KULLIMIT FORTESE – CELINË
Grupi 3.	Lot 3 – VAZHDIMI I NDËRTIMIT TË KANALIT TE KULLIMIT TË TOKAVE BUJQËSORE NË RATKOC	Lot 3 – VAZHDIMI I NDËRTIMIT TË KANALIT TE KULLIMIT TË TOKAVE BUJQËSORE NË RATKOC
Grupi 4.	Lot 4 – NDËRTIMI I URËS DHE KANALIT TË KULLIMIT NË ÇIFLLAK	Lot 4 – NDËRTIMI I URËS DHE KANALIT TË KULLIMIT NË ÇIFLLAK

Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është: 1

II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 4 436 080,14

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm (përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)
Sipas Përshkrimit të Çmimeve

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj 36 apo ditë (nga dhënia e kontratës)
apo
Fillimi
Përfundimi

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit

Po ☒ Jo ☐	<i>Nëse po</i>, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose 10 % e vlerës së kontratës % e vlerës së kontratës
III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t'ju jepet kontrata (nëse aplikohet): a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i jepet kontrata, për ekzekutimin e kontratës; b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në mënyre individuale dhe apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit; dhe d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.	
III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës Po ☐ Jo ☒ <i>Nëse po</i>, përshkrimi i kushteve të veçanta	

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 Ligjin Nr. 04 L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Dëshmia 1 Deklarata nën betim – e nënshkruar dhe e vulosur (ky dokument është pjesë e dosjes)
Kërkesa 2 Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore, se ju nuk keni obligime borxhe të tatimeve në ATK. Vlefshmëria e vërtetimit duhet të jete maksimumi 90 dite nga data e lëshimit deri në datën e hapjes së ofertave. Vërtetimi kërkohet origjinal ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK.	Dëshmia 2 Vërtetimi i ATK (i verifikuar në web faqen e ATK-se)
Kërkesa 3 Dëshmi se kompania (biznesi) nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata kompetente. Vërtetimi kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vetëm nga Operatori Ekonomik që propozohet për shpërblim të kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e AK dhe nuk duhet të jete më i vjetër se 180 dite nga data e lëshimit deri në ditën e dorëzimit të ofertës.	Dëshmia 3 Vërtetimi nga gjykata kompetente (Origjinal ose kopje e noterizuar nga noteri)
	• Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet me kontratë të

	sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2, 3, i jep te drejte Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj si të papërgjegjshme ta bëjë konfiskimin e sigurimit të tenderit dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale: Kërkesa 1 Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2 Regjistrimi i TVSH – së	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Dëshmia 1 Certifikatën e regjistrimit te Biznesit – se bashku me informatat për biznesin, te lëshuar nga Autoritetet e Regjistrimit te Biznesit – Kopje Dëshmia 2 Certifikatën e TVSH – Kopje
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve te fundit, në vlerë jo më pak se LOT I 4,900,000.00 euro LOT II 640,000.00 euro LOT III 1,720,000.00 euro LOT IV 1,560,000.00 euro - Ne rast koncersiumi lideri duhet të ketë te paktën 60 % te qarkullimit. Kërkesa 2 Operatori Ekonomik duhet të ketë Kapital te mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mbështetje nga Banka ose akces në kredi nga banka në vlerë prej së paku 100,000.00 €	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Dëshmia 1 Deklaratat Tatimore vjetore të dorëzuara në ATK ose Raport nga Banka e vulosur dhe e nënshkruar origjinale nga ndonjë banke e licencuar ne Kosovë Shënim Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 Lote, shuma më e lartë e vlerës se qarkullimit financiar që kërkohet për Lotet për të cilat konkurron duhet të përmbushet nga OE. Shembull Nëse OE vendos që të konkurrojë në Lot 1 dhe 2, atëherë kërkesa minimale e qarkullimit financiar e cila duhet të përmbushet nga OE është 4,900,000.00 euro, Nëse OE vendos qe te konkurroj ne Lot 3 dhe 4, atëherë kërkesa minimale e qarkullimit financiar e cila duhet te përmbushet nga OE është 1,720,000.00 euro Dëshmia 2 Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar lidhur me këtë projekt. Shënim Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për Dy (2) Lote, Tre (3) apo për të gjitha Lotet, vlenë vetëm vlera e kërkuar sipas Kërkesës nr. 2 e cila duhet të përmbushet nga OE.
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: Kërkesa 1 Numri i punëtorëve të angazhuar në këtë projekt, minimum. 20 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani. Kërkesa 2 Operatori Ekonomik duhet te ketë ne listen te paktën këtë staf profesional 2.1. Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Hidroteknik, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit. 2.2. Udhëheqesi i Punishtes – Inxhinier i	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Dëshmia 1 Lista e numrit të punëtorëve të angazhohen për kryerjen e punëve, minimum. 20 punëtor me të dhënat në vijim Emri, mbiemrin, mosha e punëtorit, profesioni, eksperiencia (vite) dhe pozicioni në kompani – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik. Shënim Kjo kërkesë duhet te plotësohet, për secilin Lot ne veçanti Dëshmia 2 • Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar; • CV-të për stafin profesional - inxhinieret (të nënshkruar nga vetë pala); • Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë projekt; • Letër referencë për punët e mëparshme në

Diplomuar Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit. 2.3. Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me dy (2) vite përvojë pune pas diplomimit ose gjeodet (shkolla e lartë), ose Bahcelor i diplomuar i gjeodezisë me tri (3) vite përvojë pune pas diplomimit.	lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit; • Nje reference nga ndonjë Autoritet Kontraktues apo Kontraktor ne Kosove qe Menaxheri i Projektit ka menaxhuar projekte nga lemia e kërkuar, për pikën 2.1 • Një deklaratë me shkrim për caktimin e menaxherit te projektit dhe Udhëheqesit të Punishtes – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën 2.1 & 2.2 • Licenca e Noterizuar e Gjeodetit për pikën 2.3.
Kërkesa 3 Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme (Rregullimi Ndertimi i shtratit te lumenjeve ose Rregullimi Ndertimi i kanioneve ose Rregullimi Ndertimi i kanaleve te ujitjes ose kanaleve derivuese), në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, në vlerë min. LOT I 3,650,000.00 euro LOT II 483,000.00 euro LOT III 1,295,000.00 euro LOT IV 1,175,000.00 euro - Ne rast konkursiumi lideri duhet të ketë te paktën 60 % te projekteve te realizuara.	Dëshmia 3 Lista e projekteve te kryera në lëmin e punëve të ngjashme (Rregullimi Ndertimi i shtratit te lumenjeve ose Rregullimi Ndertimi i kanioneve ose Rregullimi Ndertimi i kanaleve te ujitjes ose kanaleve derivuese), të realizuar në tri vitet e fundit, nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duke saktësuar Titujt e projekteve, shumën e kontratës, numrin e Prokurimit, data e kontraktimit – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik, DHE dëshmitë e përfundimit, Referenca t ose Pranimi teknik. (Nëse kontratat janë të kontraktuara me subjekte private kombëtare e ndërkombëtare, atëherë ato duhet të dëshmojnë me qarkullime bankare për atë kontratë - referencë - kontratës, bashkangjitur pagesën bankare). Shënim Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 Lote ose me shume Lot, shuma më e lartë e vleres se kontratave te realizuara që kërkohet për Lotet për të cilat konkurron duhet të përmbushet nga OE. Shembull Nëse OE vendos që të konkurrojë në Lot 1 dhe 2, atëherë kërkesa minimale e puneve te realizuara e cila duhet të përmbushet nga OE është 3,650,000.00 euro, Nëse OE vendos qe te konkurroj ne Lot 3 dhe 4, atëherë kërkesa minimale e puneve te realizuara e cila duhet te përmbushet nga OE është 1,295,000.00 euro
Kërkesa 4 Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me keto Certifikata ISO - EN-ISO 9001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë) - EN-ISO 14001-2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit) - BS OHSAS – ISO 45001-2018 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë) - EN-ISO 39001-2012 (Certifikata për Menaxhimin të Sigurisë së Trafikut Rrugor)	Dëshmia 4 Certifikatat Valide dhe Kopje e noterizuar nga origjinali.
Kërkesa 5 Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit - Tre (3) Kamion kipper - Dy (2) Eskavator me kapacitet deri 10 ton - Dy (2) Eskavator 15-20 ton - Tre (3) Luge ngarkuese - Dy (2) Ngjeshese (Cilinder Valak) te tokes - Dy	Dëshmia 5 Lista origjinale e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik e pajisjeve – mjeteve te punës në dispozicion për realizimin e punimeve. Deklaratat unike doganore ose kontrata fatura e blerjes për automjetet qe nuk regjistrohen dhe Librezat e qarkullimit për

(2) Papuqe vibruese (Viber pllaka) - Një (1) Buldozher shtyes, mbi 12 ton - Një (1) Greder	automjetet qe regjistrohen. Ne rastet kur Operatori Ekonomik ka kontrate apo marrëveshje mbi shfrytëzimin e pajisjeve - qera me ndonje operator ekonomik, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytëzim – Orgjinale ose Kopje e noterizuar, kontrata apo marrëveshje duhet te jetë me titull të projektit.
---	---

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

Po ☐ Jo ☐ III.3.1) Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar <i>Nëse po</i> , referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse
III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve Po ☐ Jo ☐

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës
☒ E hapur
☐ E kufizuar
☐ Konkurruese me negociata
☐ Kuotim i Çmimit
IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim <i>(procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)</i> Në bazë të aplikacioneve të pranuar, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:
IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave <i>(procedurë konkurruese me negociata)</i> Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme Po ☐ Jo ☐ në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata Po ☐ Jo ☐
IV.1.4 Numri minimal i kandidateve të cilët do të ftohen që të dorëzojnë Tenderët fillestar është:
IV.1.5. Informata në lidhje me ankandin elektronik Do të përdoret ankandi elektronik: Po ☐ Jo ☒

Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik:

IV.2) KRITERET E DHËNIES

☒ Çmimi më i ulët

ose

☐ Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë

Po ☒ Jo ☐

Nëse po,

Njoftim paraprak: **2021/623-21-2485-5-1-1/001-0007247 28.04.2021** i

Publikime tjera (nëse aplikohen):

i
i

Po ☐ Jo ☒

Dokumentet me pages

Nëse po, çmimi EUR

Kushtet dhe metoda e pagesës:

IV.3.2) Afati i fundit për pranim të tenderëve / aplikacioneve:

data **27.07.2021** *koha* **14:30:00** *vendi* **<https://e-prokurimi.rks-gov.net>**

IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e tenderëve / aplikacioneve është shkurtuar:

☐ Po ☒ Jo

Nëse po, jep arsyetim

IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:

Po ☒ Jo ☐

Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit **LOT I 40,000.00 Euro** **LOT II 6,000.00 Euro** **LOT III 17,000.00 Euro** **LOT IV 15,000.00 Euro**

Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë **120** apo muajt

IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:

Deri më: data: ditët **90** apo muajt

IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:

data **27.07.2021** *koha* **14:30:00** *vendi* **<https://e-prokurimi.rks-gov.net>**

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHITESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita në punishte etj)

• **Autoriteti Kontraktues Komune Rahovecit ju informon se sipas vendimit të KRPP – se Nr 91 2018 dhe RRUOP, që tenderi duhet të dorëzohet vetëm në mënyrë elektronike (në asnjë mënyrë në versionin tjetër). Ky është kusht i tenderit i cili duhet respektuar për të mundur pranimin e ofertës si të “përgjegjshme” administrativisht. • Në pamundësi teknik për të ngarkuar në sistem e prokurimit projektin detaj, ju informojmë se komplet projektin mund të merni në Zyren e Prokurimit – Komuna e Rahovecit, në formë fizike.**